



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

---

Numri i lëndës: 2024:190903

Datë: 30.08.2024

Numri i dokumentit: 06106559

K.DH.SH.II.nr.1495/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit “S...” Sh.p.k, me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bahrie Besimi, avokate, kundër të paditurës-kundërpropozuesi, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës-kundërpropozuesi, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal K.F.nr.379/2024 të datës 10.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.08.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës-kundërpropozuesit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal K.F.nr.379/2024 të datës 10.07.2024, Vërtetohet.

## A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, është vendosur si në vijim;

“ I. APROVOHET si i bazuar propozimi-kërkesa e paditësit propozuesit “S...” Sh.p.k me seli në Ferizaj për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ-vendimit nr.255/24 të datës 18.06.2024, të Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.

II.SHTYHET ekzekutimi i Vendimit nr.255/24 të datës 18.06.2024, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë, deri në vendosjen e këtij kontesti tregtar-administrativ me vendim përfundimtar gjyqësor.”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditurës Administrata Tatimore e Kosovës si e bazuar dhe aktvendimi i ankimuar të anulohet si i pa bazë.

Paditësi nuk ka paraqit përgjigje në ankesë edhe pse ankesën e ka pranuar me datën 14.08.2024.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi “S...” ShPK me seli në Ferizaj, pranë Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurit-kundër propozuesi Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, ndaj vendimit nr.255/24 të datës 18.06.2024, së bashku me padi ka paraqitur edhe propozimin-kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të njëjtit, deri në vendimin përfundimtar gjyqësor.

Gjykata e Shkallës së parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se, duke ju referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr.03/L-202, ku parashihet: “Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”. Ndërsa në paragrafin 6 të të njëjtit nen është përcaktuar se “Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.” Tutje kjo çështje është e përcaktuar edhe me nenin 27, par 1, të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, ku thuhet se “Jo më vonë se tre (3) ditë nga marrja e një kërkesë për masë të përkohshme ose lehtësim tjetër urgjent, në përputhje me ligjet në fuqi, dhoma e shkallës së parë e konsideron dhe vendos për një kërkesë të tillë pa dëgjim të palëve në seancë”. Ndër të tjera ka theksuar se propozimi/kërkesa e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ-vendimit nr.255/24 të datës 18.06.2024, është e bazuar, për arsye se në rastin konkret ekziston rreziku real që pa shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi, paditësi do të mund të pësonte dëm të pa riparueshëm, në rast të mbledhjes së detyrueshme të borxhit tatimor nga ana e të paditurës i cili është objekt i këtij konflikti administrativ. Deri tek ky përfundim Gjykata erdhi pasi që analizoj provat e paraqitura nga paditësi dhe atë : kontratat për kryerjen e punëve publike me autoritetet kontraktuese të nivelit komunal dhe qendror, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave të prokurimit, historiat i llogarisë nga banka ekonomike prej datës 25.06.2024 me qarkullim 0.00, lista e pagave të 31 punëtorëve të angazhuar tek këtu propozuesi me të dhëna për pagat bruto dhe neto, kontributet dhe tatimet, plani i pagesave të kredisë, sipas linjës kreditore nr. 6233216, me këst mujor prej 14,000.00 euro, dhe atë deri më datë 10.05.2025, gjendja e llogarisë bankare në R..B..., për periudhën nga 01.01.2024 deri 08.07.2024, e me bilanc përfundimtar me datë 01.07.2024 në shumë prej 2,020.05 euro, e cila shumë paraqet gjendje minimale financiare dhe insolvente për përmbushje njëherësh të obligimeve ndaj të paditurës sipas raportit të kontrollit në këtë fazë të procedurës, pa rrezikuar biznesin e tij. Në këtë situatë, Gjykata e dhomës së shkallës së parë ka vlerësuar se ekzekutimi i aktit administrativ - vendimit të ATK-së nr.255/24 të datës 18.06.2024, pashmangshëm do mund ti sillte dëme të pa riparueshme paditësit, sepse me mbledhjen e detyrueshme të borxhit tatimor nga e paditura, respektivisht marrjen e masave për mbledhjen e detyrueshme të borxhit tatimor ku do të përfshiheshin masat e parapara

me nenet 29 deri 38 të Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, si : *Masa për marrjen e pasurisë, Zbatimi me përmbarim i masës së marrjes, Shitja në ankand publik, Embargo në importe dhe eksporte, Transferimi i asetëve*, do të pamundësohej aktiviteti afarist i paditësit, çka do të rezultonte me rrezikimin e afarizmit të biznesit, me pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve financiare ndaj kredive bankare ndaj bankave, me mos përmbushjen e kontratave ndaj punëtorëve duke rrezikuar edhe marrëdhënien e tyre të punës, si dhe pamundësinë e përmbushjes së obligimeve tatimore të deklaruara ndaj vet ATK-së. Nga ana tjetër Gjykata vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar të ATK-së, nuk është në kundërshtim as me interesin publik të të paditurës e as që do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, ngase e njëjta për çdo ditë vonese në pagesën e detyrimeve tatimore nga ana e paditësit, të njëjtin e ngarkon me pagesën e ndëshkimit dhe interesit të paraparë me nenin 24, të Ligjit Nr.08/L-257.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.255/24 të datës 18.06.2024, deri në vendosjen meritore të padisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditurës-kundër propozuesit, në ankesë ndaj aktvendimit të Dhomës së Shkallës së Parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, nga provat të cilat gjinden në shkresa të lëndës si që janë; kontratat për kryerjen e punëve publike me autoritetet kontraktuese të nivelit komunal dhe qendror, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave të prokurimit, histori ati i

llogarisë nga banka ekonomike prej datës 25.06.2024 me qarkullim 0.00, lista e pagave të 31 punëtorëve të angazhuar tek këtu propozuesi me të dhëna për pagat bruto dhe neto, kontributet dhe tatimet, plani i pagesave të kredisë, sipas linjës kreditore nr. 6233216, me kështu mujor prej 14,000.00 euro, dhe atë deri më datë 10.05.2025, gjendja e llogarisë bankare në R..B..., për periudhën nga 01.01.2024 deri 08.07.2024, e me bilanc përfundimtar me datë 01.07.2024 në shumë prej 2,020.05 euro, e po ashtu e edhe duke u bazuar në nenin 29 deri në nenin 38 të Ligjit Për Administratën Tatimore, do të pamundësohej aktivitetit afarist i paditësit, me pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve financiare ndaj kredive bankare ndaj bankave, me mos përmbushjen e kontratave ndaj punëtorëve duke rrezikuar edhe marrëdhënien e tyre të punës, si dhe pamundësinë e përmbushjes së obligimeve tatimore të deklaruara ndaj vet ATK-së. Kështu edhe kolegji i kësaj gjykate vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar të ATK-së, nuk është në kundërshtim as me interesin publik të të paditurës e as që do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, ngase e njëjta për çdo ditë vonese në pagesën e detyrimeve tatimore nga ana e paditësit, të njëjtin e ngarkon me pagesën e ndëshkimit dhe interesin.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe të drejtën materiale, me rastin e aprovimit të kërkesës së paditësit/propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e aprovimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi-propozuesi, e ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura, dhe se nuk i ka konstatuar drejt gjendjen faktike, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1495/24 datës 28.08.2024

Kryetarja e Kolegjit  
Franciska Zhitija Ymeri